

**BASHKIA E TIRANËS
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
DREJTORIA E MONITORIMIT TË TERRITORIT**

Nr. D-21277 / prot. (

Tiranë 25/11 /2025

Lënda: Kthim përgjigje

✓
Z. DORIAN MATLIJA

BLV. "GJERGJ FISHTA", Nd. 24, H. 3, Ap. 7, TIRANË

Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, nga ana juaj është depozituar shkresa nr. prot. D-21277 datë 30.10.2025, ku kërkohet informacion mbi aktet e kontrollit për objektin "Godinë banimi dhe shërbime 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9; 10 dhe 11 kat me 2 kat parkim nëntokë", me adresë në rrugët "Qemal Stafa" dhe "Faik Tërnova", Nj. Ad. nr. 2, miratuar me vendimin nr. A-15458/6 datë 19.10.2022, leje ndërtimi nr. prot. A-15458/8 datë 17.12.2022, me zhvillues dhe subjekt ndërtues shoqëria "A&G Construction" sh.p.k.

Për sa më sipër, ju informojmë se me anë të kërkesës A-1302 datë 21.01.2025, subjekti "A&G Construction" ka depozituar dokumentacionin për konfirmimin e akt-kontrolleve të kantierit të punimeve, piketimit të objektit, përfundimit të themeleve dhe kuotës $\pm 0.00\text{m}$ dhe përfundimit të karabinasë.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit i është kthyer përgjigje subjektit me anë të shkresës nr. A-1302/1 datë 04.04.2025 mbi mangësitë në dokumentacionin e depozituar. Për pasojë për këtë objekt nuk ka asnjë akt-kontroll të konfirmuar sipas fazave të ndërtimit, referuar VKM 408/2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" (i ndryshuar).

Referuar kërkesës tuaj, bashkëlidhur po ju dërgojmë një kopje të dokumentacionit të depozituar nga shoqëria ndërtuese për konfirmimin e akt-kontrolleve si dhe shkresën kthim-përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM



Eldi Hoxha